

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim. Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.G., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 187 par. 1 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit A.G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr. 595/2017 të datës 29.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 01.03.2019, mori këtë:

## AKTGJYKIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit A.G., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr. 595/2017 të datës 29.11.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr. 595/2017 të datës 29.11.2018, të akuzuarin A.G., e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale Sulmi, nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata e shkallës së parë do t' ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh, ashtu që për çdo ditë të kaluar me burgim do ti llogaritet nga 20 €, të gjobës. I akuzuari A.G., është detyruar, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. I dëmtuari M.G. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari A.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi dënimin dhe vendimit mbi shpenzimet procedurale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen penale ta kthej në rigjykim dhe vendim ose të njëjtin ta ndryshoj ashtu që i akuzuari të lirohet nga aktakuza.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.63/2019 datë 06.02.2019, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit A.G., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Me ankesën e të akuzuarit, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase aktgjykimi i ankimuar është tendencioz dhe në vete nuk përmban arsye mbi rrethanat relevante. Arsyetimi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat materiale me shkresa e lëndës dhe deponimet e palëve procedurale ngase i njëjti aktgjykim është rrjedhojë e një shtytjeje dhe nxitjeje duke cituar fjalët se “më mirë të pranosh fajin se sa të lëshohemi në gjykim”. I akuzuari po ashtu deklaroi se ka rënë në lajthim nga ana e disa individëve në gjykatë, kur i njëjti ka pranuar fajësinë, se gjithashtu nuk ka pasur të holla për të paguar mbrojtësin për ta përfaqësuar në këtë çështje penale edhe pse dëshmitarët kanë qenë në korridor për të dëshmuar, i njëjti thekson se nuk ka pasur njohur se në rastet e tilla ka pasur të drejtë në mbrojtje profesionale nga avokati.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilat thirret i akuzuari në ankesën e tij, aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform dispozitave të nenit 394 të KPPK-së i vëren çdo herë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i shkallës së parë, pra edhe dispozitivi është mjaft i qartë dhe pa kundërthënie me vetveten dhe me faktet e cekura në arsyetim. Në arsyetim janë përshkruar në mënyrë të qartë elementet inkriminuese të akuzuarit që përbëjnë veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor në kuptim dispozitës së nenit 365 të KPPK-së, pra mënyra se si i akuzuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, veprime këto që përmbajnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën i njëjtit me të drejtë është shpallur penalisht përgjegjës dhe iu është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Pretendimet e të akuzuarit se pranimit i fajësisë është bërë pa pasur mbrojtës dhe se i njëjti nuk i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë ngase është person laik duke mos qenë i barabartë në procedurë dhe se pranimit i fajësisë nuk e ka bërë në mënyrë të vullnetshme, sipas kolegjit penal të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 29.11.2018, të cilin procesverbal e ka nënshkruar edhe vetë i akuzuari, gjykata e shkallës së parë të njëjtin, në kuptim të dispozitës së nenit 323 dhe 325 të KPPK-së, e ka njoftuar të akuzuarin për të drejtat e tij dhe atë duke e udhëzuar të akuzuarin se ka të drejtë që të mos të deklarohet për çështjen e tij, ose të mos të përgjigjet në asnjë pyetje dhe nëse deklarohet nuk është i detyruar ta inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, e as të pranohet fajësinë, të mbrohet vet ose përmes ndihmës juridike të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij..., i akuzuari A.G. ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe ka deklaruar se do të

mbrohet vet personalisht, po ashtu gjykata e shkallës së parë ia ka dhënë mundësinë që të deklarohet rreth pranimit apo mos pranimit të fajësisë, i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale ashtu sikurse që është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 248 të KPPK-së, me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë. Në këtë drejtim aktgjykimi përmban edhe arsye të qarta dhe është bazuar në fakte dhe prova të mjaftueshme përkitazi me fajësinë e të akuzuarit. Pretendimi i të akuzuarit se dëshmitarët, ditën kur është mbajtur shqyrtimi gjyqësor kanë qenë në korridor të gjykatës dhe të gatshëm për të dëshmuar që i njëjti nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, por çuditërisht, të njëjtit nuk janë marrë në pyetje, nuk është i bazuar sepse sipas nenit 248 par.4 të KPPK “ Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1. i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit” pra, nuk mirren në pyetje dëshmitarët por kalohet në fjalën përfundimtare të palëve.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas kolegjit penal të kësaj gjykate pretendimet e të akuzuarit sa i përket kësaj baze ankimore nuk janë të lejuara dhe nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës e cila vërtetohet edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor me datë 29.11.2018 edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve tjera ankimore të ushtruara me anë të ankesës së të akuzuarit.

Sa i përket shkeljs së ligjit penal, i akuzuari në ankesë pretendon se me pamjaftueshmëri dhe parregullsi në hetimin e çështjes penale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, ka ardhur deri te konkluzioni i gabuar ashtu që në dëm të akuzuarit është aplikuar kodi penal.

Kjo gjykatë pretendimet e lartcekura të akuzuarit për shkelje të ligjit penal i vlerëson si të pabazuara, pra kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin e ka shpallë fajtor për veprën penale Sulmi, nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë me akuzë. Kolegji penal i kësaj gjykate, ka ardhur në përfundim se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, se vepra penale për të cilën ndiqet i akuzuari përbënë vepër penale, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, se është zbatuar ligji i aplikueshëm. Meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat për matjen, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit kundër të akuzuarit kur është shpallur fajtor për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Me ankesë, i akuzuari aktgjykimin e ankimuar e kundërshton edhe sa i përket vendimit mbi dënimin, kur pretendon se, vendimi për sanksionin penal është i pabazuar dhe jo ligjor, se

nuk ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, sepse po ta kishte kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, do të lëshohej në shqyrtimin e çështjes penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 të KPRK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë rrethanat personale të akuzuarit, është baba i katër fëmijëve, gjendjen e tij të dobët ekonomike, është punëtor, mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij të thellë, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, më parë nuk ka qenë i dënuar, nuk është recidivist, kurse si rrethana rënduese për të akuzuarin ka marrë parasysh intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, motivet e kryerjes së veprës penale.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë sikurse që pretendon i akuzuari. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënim ndaj të akuzuarit, ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Duke pasur parasysh se në ankesën e të akuzuarit nuk është theksuar ndonjë rrethanë e re lehtësuese që nuk ka qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe që kishte për të ndikuar në shqiptimin e një dënimi më të butë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate në tërësi kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, pretendimi e të akuzuarit, se gjykata e shkallës është dashur të shqiptoj dënim më të butë është i pabazuar, ngase ekzistojnë prova materiale se në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë me elemente të veprës penale e cila i është vënë në barrë me anë të aktakuzës, gjë që vërtetohet edhe vet nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit. Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar, nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

I akuzuari e përmend si pikë ankimore edhe vendimit mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor, por në të njëjtën ankesë nuk thekson asnjë pretendim. Mirëpo kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës drejtë ka vendosur kur të akuzuarit i ka vënë në barrë shpenzimet e procedurës penale në këtë çështje penale dhe atë në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 450 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.41/19, datë 01.03.2019**

**Zyrtari ligjor**  
**Shaban Prekalla**

**Kryetari i kolegjit**  
**Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Shqipe Qerimi**

**Afrim Shala**